



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office

Datë: 16.04.2026

Nr.prot: 02/383

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale, në pajtim me dispozitën e nenit 19.16 të Rregullores 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, si dhe sipas nenit 54 të Statutit të Komunës së Shtimes, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet z. Avni Muharremi nga njësia kërkuese Drejtoria për Administratë të Përgjithshme për hartimin e specifikave teknike për aktivitetin " (D.D.D) Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi.
2. Personi i emëruar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, së bashku me specifikimet teknike do të plotësoj dhe dorëzojë deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP, ku deklaron që specifikimet teknike janë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik dhe që specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrim.

Vendimi i dërgohet:
Drejtorisë së Prokurimit
Personit të emëruar
Arkivi

